



Banka Boterore

Rajoni i Evropes dhe Azise Qendrore

Zyra e Tiranes

Contact: Ana Gjokutaj (355 42) 405 87/88/89

Email: Agjokutaj@worldbank.org

PROGRAMI I GRANTEVE TE VOGLA NDIHMON NE FUQIZIMIN E ANGAZHIMIT QYTETAR TE GRUPEVE PA PERKRAHJE TE POPULLSISE

TIRANE – 10 qershor 2002 - Prej dy vitesh Zyra e Bankes Boterore ne Tirane po u jep grante organizatave te shoqerise civile ne kuadrin e Programit te Granteve te Vogla. Objektivi i Granteve te Vogla per kete vit ishte fuqizimi i angazhimit qytetar te grupeve te menjanuara dhe te rrezikuara te popullsisë per te patur edhe ato autoresi mbi proceset e zhvillimit.

Bordi i jashtem keshillimor, i perbere nga perfaqesues te donatoreve dhe organizatave nderkombetare te angazhuara me shoqerine civile, dhe komiteti i brendshem per perzgjedhjen e granteve, i perbere nga punonjes te zyres se Bankes Boterore, shqyrtuan me kujdes 65 propozime projektesh dhe perzgjedhen 12 propozime te vlefshme per financim. Shuma e akorduar per cdo projekt varion nga 700\$ deri 4000\$ per projekt. Shperndarja gjeografike e propozimeve perfshin gjithë vendin qe nga Shkodra, Puka, Kukesi, Peshkopia, Durresi, Tirana, Gjirokastra, e Permeti.

Fitues te granteve per kete vit u shpallen OJQ-te e meposhtme me keto projekte:

- Shoqata “Ne dobi te gruas pukiane” per projektin “Fushate sensibilizimi publik dhe asistence per familjet e ngujuara nga gjakmarrja”, Puke;
- Shoqata “Te gjithë femijet kane te njejten vlere njerezore” per projektin “Te ndryshem, por te barabarte”, Shkoder;
- Shoqata “Qendra rajonale e keshillimit bujqesor” per projektin “Hapja e shkolles se gruas fermere si mjet emancipimi per grate e shperngulura nga zonat e prapambetura te vendit”, Durres;
- Shoqata Christian Children’s Fund ne bashkepunim me rrjetin e grupeve komunitare te prinderve me projektin “Debat i hapur per femijerine” qe do te shtrihet ne rrethet Tirane, Peshkopi e Kukesi;
- Shoqata “Rinia dhe femijet” per projektin “Angazhimi i grupeve te paperkrahura ne vendimarrjet e Bashkise”, Permet;
- Qendra per studime sociale dhe ekonomike per projektin “Vendosja e lidhjeve dhe shkembimi i eksperiences se popullsisë rome ne Shqiperi dhe Rumani”, Tirane;

- Shoqata “Ne dobi te gruar shqiptare” per projektin “Mbeshtetje social-psikologjike e moshes se trete nepermjet perfshirjes se grupeve te te rinjve”, Tirane – Kombinat;
- Qendra e trajnimit multidisiplinar epr problemin e keqtrajtimit te femijeve per projektin “Ngritja e klubit te nenave “Te ndihmojme njera-tjetren”, Tirane;
- Shoqate “Mjedisi natyror Jugor i Shqiperise” me projektin “Nxitja e iniciatives qytetare ne zgjidhjen e problemeve ekonomike-mjedisore te zones se Fushe-Bardhes nepermjet dialogimit dhe lobimit”, Gjirokaster;
- Shoqata “Bota e femijeve” me projektin “Te nxisim bashkepunimin e tolerancen mes adoleshenteve qe vijne nga familje me probleme sociale dhe ekonomike”, Tirane;
- Shoqate “Pjeter Bogdani” me projektin “Media ne ndihme te ndergjegjesimit te opinionit publik per komunitetin e zonave te minuara dhe autoritetet lokale ne ndihme te tyre”, Kukes;
- Instituti i studimit te opinionit publik me projektin “Ndergjegjesim i opinionit shoqeror, komunitetit dhe donatoreve mbi nevojat e grave dhe femijeve ne burgjet shqiptare”, Tirane.

Programi i Granteve te Vogla i Bankes Boterore eshte krijuar per te nxitur dialogun dhe shperndarjen e informacionit mbi zhvillimin, si edhe per te thelluar partenritetin me shoqerine civile.

-###-